

Financim bizneseve mikro, Panariti: Do t'u jap zhvillim eksporteve

Fondi 'BESA' merr hua 6 mln euro, investim në bujqësi

Tashmë fondi 'Besa' sh.a ka mundësinë të zgjerojë kreditimin për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Kjo falë marrëveshjes së nënshkruar me Bankën e Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim, në shumën prej 6 milionë euro. Kjo kredi do të përdoret në financimin e bizneseve mikro dhe SME kryesisht për financimin e projekteve të veçanta ose programeve të investimeve për krijimin, modernizimin dhe diversifikimin e projekteve në industri, bujqësi dhe prodhim, si edhe në sektorin e shërbimeve. Gjithashtu, do të përdoret si kapital qarkullues për bizneset në industri, bujqësi si edhe bizneset e përpunimit, prodhimit dhe shërbimeve, si edhe nevojave për financim për kapital qarkullues të projekteve apo investimeve të caktuara si dhe për financimin e bizneseve në sektorin e industrisë dhe bujqësisë të orientuara kryesisht drejt eksportit. Përmes



Prezantimi i marrjes së huasë

FONDI

Fondi 'BESA' sh.a. aktualisht ka rreth 28,000 klientë aktivë dhe tepriçë kredie rreth 5.6 miliardë lekë (rreth 55 milionë US\$), ndërkohë që nga fillimi i aktivitetit ka dhënë rreth 120,000 kredi në vlerën rreth 40 miliardë lekë (rreth 400 milionë US\$).

një conference për mediat, presidenti, Bajram Muça u shpreh se fondi është i vendosur të rrisë më tej aktivitetin si dhe të vazhdojë të finançojë për zhvillimin e zonave rurale. "Ne kemi ar-

ritur një performancë të lartë duke rritur aktivitetin. Do përmbushim të gjitha detyrimet nga kjo marrëveshje, shpresojmë që të jetë një fillim i mbarë pasi do vazhdojmë të investojmë

PËRDORIMI I HUASË

- Kredia do të përdoret në financimin e bizneseve mikro dhe SME kryesisht në këto qëllime:
- Financimin e projekteve të veçanta ose programeve të investimeve për krijimin, modernizimin dhe diversifikimin e projekteve në industri, bujqësi dhe prodhim, si edhe në sektorin e shërbimeve.
- Si kapital qarkullues për bizneset në industri, bujqësi si edhe bizneset e përpunimit, prodhimit dhe shërbimeve, si edhe nevojave për financim për kapital qarkullues të projekteve apo investimeve të caktuara.
- Financimin e bizneseve në sektorin e industrisë dhe bujqësisë të orientuara kryesisht drejt eksportit.

për zhvillimin e zonave rurale dhe të pazhvilluara", tha ai. Ndërkaq, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Edmond Panariti e cilësoi marrjen e kësaj huaje si një hap domethënës në ndihmë të zhvillimit të bujqësisë. "Sektori i bujqësisë ka pësuar rritje, sidomos drejt eksportit. Ek-

sporti i fruta-perimeve u rrit me 28%, gjatë 5-mujorit të parë të këtij viti, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërkohë që, premiset janë që ky fond t'i japë zhvillim më të madh sektorit bujqësor e sidomos eksporteve", u shpreh Panariti. Ndërkohë që, kreu i Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvil-

lim, Mustafa Boran u shpreh se ky nuk do të jetë bashkëpunimi i parë, ndër sa theksoi se vlera prej 6 milionë euro tashmë është disbursuar. Realizimi me sukses i kësaj marrëveshje huaje midis fondit 'BESA' sh.a. dhe Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim është një mbështetje dhe vazhdim i misionit të fondit për të kontribuar në rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë së vendit në zonat urbane dhe gjysmë-urbane, nëpërmjet financimit të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në Shqipëri. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë konsideruar si shtylla e ekonomisë shqiptare dhe përbëjnë mb. 70% të gjithë punësimit, më shumë se 70% të GDP-së vjetore dhe përbëjnë gati 99% të gjithë bizneseve të regjistruara në Shqipëri. Ato konsiderohen si instrumenti më eficient për ekonominë në tranzicion, i cili gjeneron rritje ekonomike të qëndrueshme, punësim dhe reduktim të varfërisë.